

Asociacioni i Komunave të Kosovës
Asocijacija Kosovskih Opština
Association of Kosovo Municipalities

avokim

shërbime

lobim

praktika

promovim

për interesa të komunave

në këtë numër:

- 2 Këshilli i Kryetarëve debaton agjenden vjetore legjislative dhe çështjen e privatizimeve e pronave komunale
- 2 AKK-ja koordinon aktivitetet me partnerët e qeverisjes lokale
- 12 Komunave të i'u kthehen pronat e tyre me qëllim të realizimit të interesit publik
- 6 AKK-ja ka nënshkruar Memorandumin e Bashkëpunimit me UNICEF-in
- 6 AKK në bashkëpunim me projektin DEMOS, organizuan punëtorinë për hartimin e model rregullore për subvencione

KOSOVA MERR UDHËHEQJEN E ORGANIZATËS QË TUBON AUTORITETET LOKALE NË EVROPËN JUGLINDORE

Kryetari i AKK-së z.Naim Ismajli është zgjedhur Kryetar i NALAS-it

Kuvendi i Përgjithshëm i AKK-së miratoi Planin Strategjik 2016-2020



'Projekti që përmirësoi eficiencën e energjisë në tri komuna të Kosovës'



Task Forca e Eficiencës së Energjisë në kuadër të NALAS (rrjeta e Asociacioneve të Autoriteteve Lokale në Evropën Juglindore) dhe Projekti i GIZ-ORF 'Eficiencia e Energjisë në Asociacionet e Komunave' kanë mbajtur takimin e përbashkët për të diskutuar masat e eficiencës së energjisë së zbatuar dhe sfidat e eficiencës së energjisë në nivelin lokal, me 8-9 Mars 2016. Vlen të ceket se Task Forca e Eficiencës së Energjisë në kuadër të NALAS udhëheqet me sukses të plotë nga Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe është njëri ndër grupet me rezultatet me të shtrira në praktikë tek autoritetet lokale.

Në këtë takim, gjashtë Asociacionet e Komunave, anëtarë të NALAS: Kosova, Mali i Zi, Serbia, Bosnja e Hercegovina dhe Maqedonia prezantuan arritjet e tyre në kuadër të projektit, të cilat përmirësuan eficiencën e energjisë në një numër të komunash në secilin shtet. Këto masa përfshinin eficiencën e energjisë në ndërtesat publike, spitalet, kopshtet e fëmijëve, konviktet e studentëve, qendra të komunitetit, ndriçimit të rrugëve, etj. Në këtë kontekst, Planet e Veprimit për Energji të Qëndrueshme (SEAPs) janë përgatitur me sukses të plotë për tri komuna të Kosovës si dhe projekti gjithashtu ka rritur vetëdijësimin e publikut në komuna të synuara. Gjatë gjithë procesit, kapacitetet e Asociacioneve të Autoriteteve Lokale janë ngritur në përmirësimin strategjik të eficiencës së energjisë. Z.Sazan Ibrahim në emër të NALAS-t dhe të AKK-së kërkoi që ky projekt të vazhdohet edhe në të ardhmen si dhe ceku edhe faktin se Kosova përmes këtij projekti ka anëtarësuar dy komuna në Konventën e Kryetarëve në Bruksel.

Poashtu në këtë takim u prezantua edhe Raporti "Zbatimi i legjislacionit të BE-së për masat e eficiencës së energjisë në nivel lokal në Evropën Juglindore" që është produkt i Task Forcës për Eficiencë të Energjisë në kuadër të NALAS-it.

KËSHILLI I KRYETARËVE debaton agjenden vjetore legjislative dhe çështjen e privatizimeve e pronave komunale



Nën organizim të Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK), Këshilli i Kryetarëve ka mbajtur takimin e rradhës ku përveç Kryetarëve të Komunave kanë marrë pjesë edhe Zëvendës Ministri i Ministrisë së Financave (MF) z.Agim Krasniqi, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) z.Arben Çitaku, z.Salvador Elmazi – Drejtor i Departamentit të Buxhetit në MF, z.Petrit Gashi – Kryetar i Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), z.Avni Jashari – U.D. Zëvendës Drejtor Menaxhues në AKP.

Takimin e drejtori kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës z.Naim Ismajli i cili informoi të pranishmit se ky takim i Këshillit të Kryetarëve është thirrur për të debatuar me përfaqësues të nivelit qendror lidhur me programin legjislativ të Qeverisë dhe implikimet në pushtetin lokal, me theks plotësim ndryshimet tek Ligji për Financat Lokale dhe atë për Partneritetin Publiko Privat, pastaj Ligji për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme Komunale si dhe Ligji për Trajtimin e Ndërtimeve Paleje dhe UA për Hartat Zonale.

Poashtu në këtë takim është debatuar lidhur me çështjet e privatizimit në interes të komunave të Kosovës si dhe për sfidat e qeverisjes lokale gjatë vitit 2016, të paraqitura nga Kryetarët e Komunave të Republikës së Kosovës.



AKK-ja koordinon aktivitetet me partnerët e qeverisjes lokale

Asociacioni i Komunave të Kosovës organizoi takimin e rregullt me partnerët e saj në takimin “Miqte e AKK-së” në Prishtinë, me qëllim të bashkëpunimit dhe koordinimit të aktiviteteve me partnerë të përfshirë në aktivitetet dhe projektet e qeverisjes lokale në Kosovë. Në këtë takim u prezantua Plani Vjetor i AKK-së, lista e projekt-ligjeve që do të involvohet AKK-ja dhe vlerësimi i nevojave për trajnim të komunave të Kosovës.

Në këtë takim ku morën pjesë përfaqësuesit e dhjetëra partnerëve dhe mbështetësve të AKK-së por edhe të Komunave të Kosovës, fjalën hapëse e mbajti z.Sazan Ibrahim, Drejtor Ekzekutiv i AKK. Ai më pas njoftoi të pranishmit në pika të shkurta për natyrën dhe qëllimin e takimit, theksoi rolin e veçantë dhe rëndësinë e bashkëpunimit me partnerët që merren me qeverisjen lokale në projekte të ndryshme në interes të komunave si dhe bëri prezantimin e Planit Vjetor të Punës 2016 si dhe listën e projekt-ligjeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës në të cilat do të involvohet Asociacioni i Komunave të Kosovës. Në këtë pikë, përfaqësuesit e partnerëve të qeverisjes lokale në Kosovë shprehën interesim për involvim të përbashkët dhe lobim për interesa të autoriteteve lokale.

Ndërsa z.Gani Berisha – Menaxher i Programit në AKK-së bëri prezantimin e Vlerësimit të Nevojave për Trajnim të zyrtarëve komunal në fusha të ndryshme, vlerësim që ka ardhur si rezultat i nxjerrjes së kërkesave nga vetë komunat dhe zyrtarët e tyre përmes Kolegjiumeve Profesionale.

Nga shumica e pjesëmarrësve u paraqitën edhe aktivitetet e tyre në fushat e ndryshme ku mund të ketë bashkëpunim dhe koordinim të aktiviteteve të përbashkëta së bashku me komunat në realizimin e objektivave të qarta të cilat kanë gjatë mandatit të tyre këto organizata. Sigurisht njëra ndër sfidat ende mbetet bashkëpunimi më i mirë nga donatorët në fusha të ndryshme gjatë zbatimit të projekteve të tyre andaj edhe bashkëveprimi i aktiviteteve duhet të jetë në funksion të organizimit sa më të mirë të punës, në mos dyfishimin e aktiviteteve dhe projekteve nga partnerët të ndryshëm.



KOSOVA MERR UDHËHEQJEN E ORGANIZATËS QË TUBON AUTORITETET LOKALE NË EVROPËN JUGLINDORE

Kryetari i AKK-së z.Naim Ismajli është zgjedhur Kryetar i NALAS-it

Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës z.Naim Ismajli është zgjedhur Kryetar i NALAS-it (Rrjeti i Asociacioneve të Autoriteteve Lokale në Evropën Juglindore) në Kuvendin e Përgjithshëm të NALAS-it i cili është mbajtur në Prishtinë me 14 dhe 15 Prill 2016.

Më shumë se 100 përfaqësues të Komunave dhe të Asociacioneve të Autoriteteve Lokale nga mbarë Evropa Juglindore ishin në Prishtinë për të marrë pjesë në Kuvendin e XI të Përgjithshëm të NALAS-it, i cili organizëm tubon 15 Asociacione të Autoriteteve Lokale nga 12 shtete të Evropës Juglindore, e ku Asociacioni i Komunave të Kosovës është edhe njëri nga anëtarët themelues të kësaj organizate. **Kryetari i Asociacionit të**

Komunave të Kosovës dhe Kryetari i ri i NALAS-it z.Naim Ismajli në fjalën e tij u zotua se do të vazhdoj punën e mirë të NALAS-it në shtetet e Evropës Juglindore për të vënë në pah mundësitë maksimale karshi sfidave që kanë komunat në këtë pjesë të Evropës. Në mandantin tim, do t'i japim përgjigje pyetjes: Pse jemi së bashku në NALAS? – sepse interesi i Asociacioneve tona dhe komunave që ne udhëheqim është i përbashkët për shërbime e përvoja më të mira dhe në tejkalimin e sfidave së bashku, sepse vetëm kështu do jemi më të fuqishëm. Kuvendin e Përgjithshëm të NALAS-it e përshëndeti edhe **kryetari i komunës së Prishtinës z.Shpend Ahmeti**, në cilësinë e nikoqirit. Ai pasi u dëshiroj mirëseardhje përfaqësuesve të komunave të shteteve nga Evropa Juglindore në kryeqytetin e Republikës së Kosovës, foli për angazhimet dhe projektet e komunës së Prishtinës. Ndërsa duke folur për qeverisjen lokale në Kosovë, kryetari Ahmeti tha se "Asociacioni i Komunave të Kosovës mund të jetë



model në Evropën Juglindore për bashkëpunimin në mes komunave që vijnë nga parti të ndryshme në interes të institucioneve të qeverisjes lokale karshi atyre qendrore dhe për shërbime më të avancuara për qytetarët e komunave tona".

Kuvendi i Përgjithshëm i NALAS-it aprovoi Raportet vjetore 2015 si dhe finalizoj Planin e Punës 2016 si dhe debatoi për temat specifike që kanë adresuar autoritetet lokale nga shtetet e Evropës Juglindore si çështjet e politikave të lidhura me krizën e refugjatëve dhe të migrimit; integrimin gjinor në nivel lokal dhe menaxhimin e mbeturinave të ngurta në zonat rurale dhe bregdetare.

Kush është NALAS-i: NALAS sjell së bashku 15 Asociacione që i përfaqësojnë afërsisht 9000 autoritete lokale, të zgjedhura drejtpërdrejt nga më shumë se 80 milionë qytetarë të Evropës Juglindore. NALAS-i promovon procesin e decentralizimit, kontribuon në procesin e stabilizimit e bashkërendimit në rajon dhe tani e tutje kontribuon në procesin e Integrimi Evropiane për të gjithë rajonin. NALAS-i inicion dhe ndërmerri iniciativa rajonale për anëtarët e vet dhe i ndihmon asociacionet për t'u bërë përfaqësues të qëndrueshëm të autoriteteve lokale përball pushtetit qendror. NALAS-i ofron shërbime për qeveritë lokale për të mirën e qytetarëve në rajon, nëpërmjet Qendrës së saj të Njohurive për zhvillimin e qeverisë lokale.



Shkurtimisht

- AKK-ja mori pjesë në punëtorinë e organizuar nga Agjencioni për Barazi Gjinore në bashkëpunim me DEMOS-in, për diskutimin e Draft-Rregullores për përkrahimin e vendeve të punës për zyrtare për barazi gjinore në nivel qendror dhe lokal.

- Në bashkëpunim me DEMOS-in, Zyrtarët për Integrimi Evropiane (ZIE) dhe përfaqësuesit e MAPL-së u organizua punëtorja për Integrimi Evropiane në Durrës dhe Ulqin, për të nxjerrë praktikën e këtyre dy shteteve dhe rruga të cilën e kanë kaluar për

integrimi si dhe plotësimin e formularëve të cilët ZIE e plotësojnë për raportim.

- Komunave i'u është shpërndarë Projekt-ligji për Inspektoratin e Arsimit për të dhënë komentet dhe rekomandimet e tyre.

Kuvendi i Përgjithshëm i AKK-së miraton Planin Strategjik 2016-2020

Prishtinë, 16 Mars 2016 – Asociacioni i Komunave të Kosovës ka mbajtur Kuvendin e Përgjithshëm Vjetor ku kanë marrë pjesë 82 delegatë nga Komunitetet e Republikës së Kosovës dhe kryetarët e komunave. Kryetari i AKK-së z.Naim Ismajli hapi punimet e Kuvendit dhe paraqiti para të pranishmëve agjendën e punës së këtij takimi të organit më të lartë të Asociacionit të Komunave të Kosovës.



Kuvendi i Përgjithshëm Vjetor i AKK-së sot debatoi për raportet vjetore të punës dhe atë financiar për vitin 2016, shqyrtoi Draftin e Planit Strategjik të AKK-së 2016-2020 si dhe debatoi për agjendës legjislative të Qeverisë së Republikës së Kosovës 2016 dhe për çështjet tjera të lobimit në interes të Komunave të Kosovës.

Duke bërë paraqitjen e Raportit të Punës të AKK-së për vitin 2015, kryetari z.Naim Ismajli ndër të tjera tha se “sa i përket punës së AKK-së gjatë vitit 2015, në cilësinë e kryetarit, paraqes disa nga pikat kryesore të realizuara nga ana e strukturave të AKK-së në shërbim të interesave të Komunave, sepse më gjerësisht ato janë përshkruar në Draft – Raportin e Punës 2015. Asociacioni i Komunave të Kosovës në periudhën mes dy Kuvendeve duke ndjekur objektivat dhe qëllimet e veta, ka

punuar fuqishëm në lobim dhe avokim për interesa të komunave të Republikës së Kosovës. Në këtë drejtim është punuar në ndryshimin dhe amendamentimin e akteve ligjore, implementimi i të cilave prek fushëveprimtarinë e komunave. Angazhimet e strukturave të AKK-së në vitin 2015, si Bordit, Këshillit të Kryetarëve, Kolegjiumeve të AKK-së dhe pjesës ekzekutive kanë qenë të orientuara në përmbushjen e objektivave të AKK-së, synimeve strategjike dhe planeve vjetore të punës.

AKK-ja është kyçur në agjendë legjislative të Qeverisë e Kuvendit të Kosovës duke qenë pjesë e grupeve punuese në shqyrtimin e projektligjeve dhe akteve tjera ligjore në ekzekutiv dhe ka marrë pjesë në trupat e Parlamentit në takime dhe në disa dëgjime publike për të mbështetur qëndrimet dhe interesat e komu-

nave të Republikës së Kosovës.

AKK-ja ka adresuar rreth 31 kërkesa në nivelin qendror dhe rezultati i inkorporimit të kërkesave dhe rekomandimeve në interes të komunave shkon në 75 për qind të suksesit.

Në këtë periudhë lobimi, AKK-ja ka qenë e përqendruar në: Ligjin për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, Ligjin për partneritetin publiko-privat, Ligjin për pyjet, Ligjin për tatimin në pronë, Ligjin për pagat dhe Ligji për barazi gjinore. Në të njëjtën kohë, AKK-ja ka konsoliduar qëndrimet për çështjet tjera: Katalogu i vendeve të punës dhe Falja e borxheve për disa kompani publike.

Ndër aktivitetet kryesore gjatë vitit 2015 vlen të cekem:

– Si një risi, përcaktimi i anëtarëve të Komisionit të Granteve nga ana e komunave u bë dy herë në takime të AKK-së, e ku morën pjesë ministra dhe sekretarë të përgjithshëm të ministrive.

– AKK-ja e ka përparuar raportin me Kuvendin e Kosovës, Komisionet Parlamentare dhe me deputetet e Kuvendit, duke e theksuar rolin e saj qendror në avokim për komunat. Përfaqësuesit e AKK pastaj morën pjesë në procesin e hartimit të projektligjeve si hapat përgatitore për ligjet përfundimtare.





– Duke u bazuar në lobimin e AKK-së, Ministria e Financave u zotua se nuk do të përgatisë asnjë dokument që prek komunat e që nuk do të jetë i kyçur edhe Asociacioni i Komunave të Kosovës. Po ashtu edhe Ministria e Arsimit u zotua se shkollat nuk do të ndërtohen nga kjo Ministri por nga vetë komunat me që vlerësimi i komunave është më meritë për këtë çështje.

– Ndihma e AKK-së për lobim tek Qeveria qendrore për disa agjensione dhe institucione qeveritare në përcaktimin e agjendës legislative në nivelin qendror vlerëson ndikimin tonë.”

Kryetari Ismajli në rezymen e tij poashtu renditi edhe aktivitetet dhe rezultatet edhe në fusha të tjera të punës dhe veprimtarisë së Asociacionit të Komunave në vitin 2015. Poashtu në këtë rast u paraqit edhe Raporti Financiar 2015 i AKK-së.

Delegatët e Kuvendin me shumicë votash miratuan Raportin e Punës dhe atë Financiar të AKK-së për vitin 2016.

Kurse Planin Strategjik 2016-2020 në pika detaje e paraqiti Drejtori Ekzekutiv i AKK-së z.Sazan Ibrahim, i cili tha se vizioni i synimeve tona strategjike “në shërbim të komunave

për të avancuar demokracinë lokale dhe cilësinë e jetesës për qytetarët” pasqyron më së miri fushëveprimtarinë tonë në interes të pushtetit lokal. Ky dokument pas debatit nga ana e delegatëve, u miratua me shumicë votash.

Në pikën tjetër të rendit të ditës, çështjet e lobimit në interes të Komunave të Republikës së Kosovës, poashtu drejtor Ibrahim paraqiti një rezymë të agjendës legislative të Qeverisë së Kosovës dhe involvimin e strukturave të AKK-së në ligje të caktuara të cilat prekin fusha të qeverisjes lokale në vend. Delegatët debatuan edhe për çështje tjera të lobimit në interes të komunave.

Delegatët e Kuvendit të Përgjithshëm Vjetor të AKK-së debatuan edhe lidhur me problemin e pagave apo meditjeve për anëtarët e Kuvendeve të Komunave, për të cilën çështje Kuvendi doli me një deklaratë mbështetëse dhe për të lobuar në të ardhmen përsëri për këtë temë, me që u konstatua nga të pranishmit se ky kompensim për anëtarët e zgjedhur nga qytetarët të Kuvendeve të Komunave, nuk është as i dinjitetshëm as në harmoni me përgjegjësitë dhe obligimet që kanë këta të zgjedhur komunalë.

Vlerësohet bashkëpunimi i deritashëm dhe mundësitë për të ardhmen

Një ekip vlerësues për projektin e GIZ/SMS (dr.Winfried Schneider dhe dr.Christina Kamlage) vizitoi Asociacionin e Komunave të Kosovës ku u takua me përfaqësues të ekzekutivit kryesuar nga z.Sazan Ibrahim - Drejtor Ekzekutiv.



Në këtë takim u debatura lidhur me bashkëpunimin e deritashëm mes GIZ/SMS dhe Asociacionit të Komunave të Kosovës në interes të autoriteteve lokale në Republikën e Kosovës dhe mundësitë dhe format më të mira të bashkëpunimit në projektet e ardhshme.

Z.Ibrahimi njoftoi bashkëbiseduesit me strukturën dhe mënyrën e funksionimit të Asociacionit të Komunave me theks në veprimet e saja lobuese dhe të shërbimeve për komunat, përfshirë edhe bashkëpunimin me partnerët e qeverisjes lokale në Kosovë.

Në këtë takim u kërkua që të fuqizohet bashkëpunimi me GIZ dhe projektet e saja në të ardhmen e sidomos me anë të planifikimeve të përbashkëta vjetore në mënyrë që ky bashkëpunim të jetë më i ngushtë dhe frytëzdhënës në interes të Komunave të Kosovës.



AKK në bashkëpunim me projektin DEMOS/ Helvetas, organizuan punëtorinë për hartimin e model rregullores për subvencione

Grupi punues në përbërje nga Kryesia e Kolegjiut të Zyrtarëve Ligjor, përfaqësues nga Kolegjiut i Kryesuesve, Kolegjiut i Buxhetit dhe Financave, me mbështetje nga përfaqësues nga AKK- ja, DEMOS-i dhe konsulentët e tyre hartuan draftin e parë të model-rregullores në fjalë.

Kjo model rregullore do të diskutohet edhe në Kolegjiutet profesionale të



AKK- së, me qëllim që rregullorja të kompletohet dhe të jetë sa më e zbatueshme nëpër komuna. Kjo model-

rregullore pasi të kalojë të gjitha fazat e diskutimit nga palët e interesit, pas finalizimit do të ju shpërndahet të gjitha komunave, në gjuhën shqipe dhe serbe, dhe pastaj secila komunë do ta përshtas sipas specifikave të veta. AKK vazhdimisht do të përkrah komunat në plotësimin e infrastrukturës juridike lokale, me qëllimin e mirë që Komunat të ofrojnë shërbime sa më të mira për qytetarët.

AKK-ja ka nënshkruar Memorandumin e Bashkëpunimit me UNICEF-in



AKK-ja ka nënshkruar Memorandumin e Bashkëpunimit me UNICEF-in për realizimin e projektit në fuqizimin e sistemit të qeverisjes lokale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Vlera e projektit është 40.000 dollarë dhe periodha e implementimit është 2016-2017 me mundësi vazhdimi.

Qëllimi i këtij Memorandumi të Bashkëpunimit është forcimi i bashkëpunimit në mes të AKK-së dhe UNICEF-it në fuqizimin e sistemit të qeverisjes lokale dhe garantimin që ato janë perceptuese dhe të përgjegjshme për realizimin progresiv të të drejtave të fëmijëve. Më tutje, AKK-ja dhe UNICEF-i ranë dakord të bashkëpunojnë, të zgjerojnë dhe të ruajnë marrëdhëniet e punës, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen në grupet relevante punuese, mundësitë e partneritetit dhe përfshirjen e publikut sipas nevojës në marrëdhënie jo-ekskluzive, me qëllim përmirësimin e qeverisjes lokale për fëmijët.

Sipas planit të përbashkët të punës, AKK-ja dhe

UNICEF-i do të punojnë së bashku në: - Ngritjen e kapaciteteve të autoriteteve lokale komunale për të punuar rreth të drejtave të fëmijëve në nivel komunal përmes zhvillimit dhe dokumentimit të një modeli në kuadër të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve 2016-2020, dhe në përputhje me Strategjinë për Zhvillim Kombëtar (2016 - 2021), Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve dhe politika të tjera përkatëse për të treguar se të drejtat e fëmijëve janë të përfshira në sistemet e qeverisjes komunale, - Zhvillimin e kapaciteteve të autoriteteve lokale mbi financat publike për fëmijët me fokus primar në përfshirjen sociale dhe barazi, - Zhvillimin e kapaciteteve të autoriteteve lokale në planifikimin e bazuar në dëshmi dhe menaxhimin e të dhënave, - Avokim për miratimin e legjislacionit përkatës e me ndikim tek fëmijët, bazuar në agjendën legjislative vjetore, - Organizimin e aktiviteteve të përbashkëta të tilla si seminare, konferenca, vizita studimore etj në mbështetje të qeverisjes së të drejtave të fëmijëve në nivel komunal.



Debatohet me komunat - Draft Strategjia dhe Planit i Veprimit për përfshirjen e Komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian

Nën organizimin e Zyrës për Qeverisjen e Mirë të Zyrës së Kryeministrit të Asociacionit të Komunave të Kosovës dhe me mbështetje nga 'Terre des hommes' - Kosovë dhe 'Voice of Roma, Ashkali and Egyptians' është mbajtur takimi me përfaqësuesit e komunave dhe pjesëtarëve të komunitetit RAE (Romë, Ashkali dhe Egjiptianë) për të diskutuar rreth Draft Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian në shoqërinë Kosovare 2016-2020. Qëllimi i takimit ishte që të rishikohet dhe konsultohet ky dokument strategjik edhe me përfaqësuesit e Komunave në nivel të Kosovës, e ku morën pjesë edhe z.Kushtrim Sheremti – këshilltar i Ministrit të Diasporës, znj. Jezerca Tigani, Përfaqësuese e 'Terre des hommes' Shqipëri/Kosovë, znj. Sazkia Salzmann, Përfaqësuese nga Ambasada Zviceriane në Kosovë dhe përfaqësuesit e Ambasadës Britaneze në Kosovë.

Në emër të Asociacionit të Komunave të Kosovës takimin e përshëndeti z.Sazan Ibrahim – Drejtor Ekzekutiv i cili në fjalën e tij ndër të tjera theksoi se ky është një dokument praktikë për përfshirjen e komunitetit RAE dhe si i tillë është më lehtë i zbatueshëm meqë ka të bashkangjitur edhe Planin e Veprimit. Ai tha se ky dokument



strategjik ngërthen në vetë disa sektorë si ai për arsim, shëndetësi, mirëqenie sociale etj. Poashtu z.Ibrahimi shtoi se ky dokument do të debatohet edhe me Drejtorët Komunal të sektorëve të ndryshëm përmes mekanizmave të AKK-së siç janë Kolegjiomet duke ditur faktin se shumica e dokumenteve që dalin nga niveli qendror duhet të zbatohen në nivelin lokal. Komunat edhe deri më tani kanë qenë të angazhuara në përfshirjen e komunitetit RAE në shoqërinë kosovare me anë të Komunitetit për Komunitete në nivel të Komunave por edhe me pozitën e nënkryetarit shtesë për komunitete në shumicën e komunave të Republikës së Kosovës.

Në fjalën e saj znj. Jezeërca Tigane, përfaqësuese e 'Terre des hommes' Shqipëri/Kosovë, ndër të tjera potencoi faktin se komunat kanë barën më të rëndë të zbatimit të

kësaj Strategjie në terren e cila vetëm në këtë mënyrë do të bëhet e vlefshme si dokument, e për të cilën, seili dokument strategjik duhet të mbështetet me buxhet për zbatimin e tij.

Në këtë takim u bë prezantimi i Draft Strategjisë dhe Planit të Veprimit të Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian 2016 dhe detyrimet e nivelit lokal të parashikuar në këtë kuadër, të paraqitur nga z. Habit Hajredini – Drejtor i Zyrës për Qeverisje të Mirë pranë Kryeministrit të Kosovës.

Poashtu në këtë punëtori u debatua edhe lidhur me vazhdimin e bashkëpunimit në mes Ministrisë së Diasporës dhe Komunave lidhur me regjistrin dhe ditët e diasporë si dhe caktimi/trajnimi i Zyrtarëve ndërlihdhës për Diasporën në Komuna.

Task Forca për Mbeturina të Ngurta dhe Ujë në kuadër të NALAS-it mban takimin në Prishtinë

Në Prishtinë u mbajt takimi i radhës së Task Forcës për Mbeturina të Ngurta dhe Ujë në kuadër të NALAS-it (Rrjeti i Asociacioneve të Autoriteteve Lokale në Evropën Juglindore).

Në këtë punëtori është bërë finalizimi i krahasuesit të menaxhimit të mbeturinave në Evropën Juglindore, dokument i cili është prezantuar edhe para

Kuvendit të Përgjithshëm të NALAS të mbajtur në Prishtinë, si dhe është shqyrtuar dhe janë përcaktuar prioritetet e e kësaj task Force për vitin 2016. Ndër të tjera gjatë punëtorisë së përbashkët të përfaqësuesve në këtë Task Force nga vendet pjese të rrjetit NALAS-it, u diskutua rreth aktiviteteve të zhvilluara në vitin 2015 e të cilat ishin: menaxhimi i aseteve në sektorin e pastërtisë dhe të ujit në

Evropën Juglindore, liderët lokal në Evropën Juglindore - udhëheqje për ndryshim, të dhënat për grumbullimin e mbeturinave të ngurta në Evropën Juglindore, menaxhimi i mbeturinave të ngurta në zonat ndërkufitare rurale dhe bregdetare në regjionin e Evropës Juglindore, Kongresi ISWA 2016 dhe Konferenca e ujit - Danub 2016.

Kryesia e Kolegjiut për Integritime Evropiane u takua me ministrin Yagcilar

Një delegacion nga AKK-ja, respektivisht Kryesia e Kolegjiut për Integritime Evropiane kanë zhvilluar një takim me ministrin e Ministrisë së Administratës Publike z.Mahir Yagcilar, e ku në këtë takim ishin edhe Drejtori Ekzekutiv i AKK-së z.Sazan Ibrahim, zv. ministri i Integritimeve Evropiane z.Ramadan Ilazi si dhe z.Tefik Mahmuti drejtor i Departamenti Administrimit të Shërbimit Civil.

Në këtë takim u bisedua në lidhje me Katalogun e Vendeve të Punës të Shërbimit Civil të Kosovës dhe rregullimit që ky katalog i bën Zyrave Komunale për Integritime Evropiane (ZKIE) si dhe respektimin e rregullores nr. 08/2011 për Organizimin dhe Përgjegjësitë e Zyrave Komunale për Integritim Evropian dhe si është përcaktuar në katalog pozita e ZKIE-së.

Ministri z.Yagcilar mirëpriti sugjerimet lidhur me pozitat e ZKIE-ve në komuna dhe procesin e integritimeve evropiane në vend, mirëpo theksoi se puna e katalogut të vendeve të punës në shërbimin civil është në fazën përfundimtare por i cili mund të rishikohet vetëm për ato pozita të cilat janë paraparë sipas



katalogut duke mos prekur koeficientet dhe implikimet buxhetore.

Në takim po ashtu palët u pajtuan se në takimin e përbashkët të organizuar së shpejti nga AKK-ja në bashkëpunim me MAP-in lidhur me këtë çështje, do të jenë prezent edhe

Kryesuesit e Kolegjiut ku do të diskutohen dhe shqyrtohen opsionet sa i përket ndryshim plotësimeve të mundshme të atyre pozitave në katalogun e vendeve të punës në shërbimin civil të Kosovës.

KOLEGJIUMI PËR BUXHET DHE FINANCA

Debatohen kriteret e planifikimeve të të hyrave vetanake në komuna

Kolegjiumi për Buxhet dhe Financa organizoi takimin e rregullt me qëllim përgatitjen e planit të punës dhe diskutimin e prioriteteve në fushën e financave lokale si dhe koordinimin e përgjegjësisë në realizimin e objektivave dhe aktiviteteve të Kolegjiut. Poashtu u bë edhe shqyrtimi i strategjisë legjislative në përcaktimin ligjeve me interes për diskutim nga komunat në grupet punuese qeveritare dhe ndërqeveritare në mënyrë të veçantë plotësimi dhe ndryshimin i projektligjit për Financat e Pushtetit Lokal. Njëra ndër sfidat kryesore të Drejtorëve Komunal mbetet çështja e shkurtimeve buxhetore në kategoritë e ndryshme, andaj edhe diskutimi duhet të përqendrohet në alokimin e mjeteve shtesë në bashkëpunim me Ministrinë e Financave (MF). Andaj



koordinimi sa më i mirë i politikave financiare duhet të jetë parakusht drejt një bashkëpunimi më të ngushtë në mes të MF dhe Kolegjiut për Buxhet e Financa.

Në takim po ashtu u diskutua edhe drafti në përcaktimin e kriterëve në planifikimet e të hyrave vetanake në komuna nga Ministria e Financave. Drejtori i Buxhetit nga MF-ja z.Salvador Elmazi paraqiti draftin ku shpjegoi se kjo iniciativë ka për qëllim gjetjen e disa mekanizmave në

përcaktimin e disa kriterëve të cilat do të jenë të vlefshme nga komunat dhe të realizueshme në bazë të planifikimeve buxhetore. Mirëpo ky draft dokument me kriteret (formulën) e përcaktuara nga Komisioni i Ministrisë së Financave, u konsiderua si i pafavorshëm nga Kolegjiumi për Buxhet dhe Financa për shkak se të hyrat sipas këtyre kriterëve janë të larta dhe të paarrtshëm në realizim. Andaj në bazë të debatit dhe sugjerimeve nga palët si rekomandim i përbashkët dhe më i pranueshëm për komunat ishte rishikimi edhe një herë i planifikimit të të hyrave vetanake për komunat duke marrë në konsideratë nga MF-ja rishikimin e kriterëve të planifikimit nga mesatarja e tre viteve të kaluara duke shtuar 10 % të shumës së përgjithshme.

Takim i Kryesuesve të Kolegjiumeve e Udhëheqësve të personelit me MAP-in

Asociacioni i Komunave të Kosovës organizoi takimin e përbashkët në mes të kryesuesve të kolegjiumeve, udhëheqësve të personelit komunal në bashkëpunim me Departamentin e Administratës së Shërbimit Civil të Ministrisë së Administratës Publike me qëllim diskutimin e katalogut të vendeve të punës në shërbimin civil.

Në fjalën e tij Drejtori Ekzekutiv i AKK-së, z. Sazan Ibrahim i theksoi se përkundër lobimit dhe angazhimit të vazhdueshëm përmes strukturave të ndryshme të Asociacionit të Komunave të Kosovës kanë përcjellë sugjerimet në draftin fillestar në ndryshimin e pozitave të cilat më herët nuk janë paraparë në katalog, e ku janë evidentuar një numër i titujve të punës të cilët janë të domosdoshëm për tu inkorporuar në katalogun e vendeve të punës për shërbimet civil në nivel lokal.

Në fjalën e tij drejtori i departamenti të shërbimit civil - MAP, z. Tefik Mahmuti konsideroi si shumë të dobishëm një takim të tillë në sqarimin e atyre dilemave rreth katalogut të vendeve të punës në shërbimin civil si udhëzim për të gjitha institucionet për klasifikimin dhe standardizimin e vendeve të punës si dhe për harmonizimin e përshkrimeve të vendeve të punës. Për më tepër, zbatimi i katalogut të vendeve të punës është edhe një nga çështjet e ngritura nga Komisioni Evropian në Raportin e Progresit për Kosovën ku edhe duhet të finalizojë kornizën ligjore për shërbimin civil dhe të sigurojë zbatimin e tij, në veçanti katalogun e punës dhe vlerësimin e performancës.

Në lidhje me vërejtjet e zyrtarëve komunal për pozita të caktuara z. Mahmuti edhe një herë sqaroi se përkundër konsultimeve me komunat dhe udhëheqës të personelit, shumë pak kërkesa janë adresuar për shqyrtimin në komisionin punues i



cili ka kërkuar përgjigje që propozimet në pozita të caktuara duhet të jenë në përputhje me strukturën organizative të Komunave dhe në respektim të statusit të nëpunësit civil.

Në vazhdim kryesuesit e kolegjiumeve shprehën edhe një herë pakënaqësitë e tyre në diskutimin e pozitave të caktuara sikurse janë zyrtarët ligjor, zyrtarët kryesor financiar, zyrtarët për integritet evropian, zyrtarët për teknologji informative, përfaqësuesit juridik të komunave, drejtorët e institucioneve arsimore, qendrave për punë sociale apo atyre të mjekësisë familjare, ku edhe përkundër shkresave të ndryshme nga komunat në adresë të MAP-it, e të cilët nuk kanë marrë asnjë përgjigje sa i përket harmonizimit të këtyre pozitave në katalog.

Në argumentimin e tij z. Mahmuti informoi zyrtarët komunal se përkundër respektimit të vendimeve qeveritare nga Ministria, ato bien ndesh me vetë strukturën e organizimit të komunave. Këto rregullore do të duhej të ishin respektuar dhe integruar nga vetë komunat në strukturën dhe organizimin e tyre. Sepse ato pozita nuk janë paraparë sipas organogrameve komunale, DASHC-MAP ka punuar në gjetjen e alternativave të mundshme sa i përket

një modifikimi në sistematizimin e këtyre zyrtarëve në ranglistën e katalogut të vendeve të punës.

Sa i përket përzgjedhjes së drejtorëve të shkollave, qendrave të mjekësisë familjare apo qendrave për punë sociale ende ka dilema nëse këto struktura udhëheqëse janë shërbyes civil apo profesional. Duke marrë parasysh se ata janë shërbyes civil mirëpo përzgjedhja e tyre kërkon kritere profesionale ka nxitur konfuzion përmes vendimeve të KPMSHC-së, andaj edhe DASHC është në koordinim me Ministrinë e Linjës në sqarimin e kësaj çështje dhe rishikimin e mundësive edhe të legjislacionit ekzistues deri në zgjidhjen përfundimtare e këtij problemi.

Në fund të takimit si rekomandim i përbashkët është formimi i grupit të përbashkët punues në mes të strukturave të AKK-së (kryesues të kolegjiumeve, udhëheqës të personelit në komuna), dhe zyrtarëve të DASHC-MAP në diskutimin dhe gjetjen e alternativave të mundshme në rishikimin e atyre pozitave të cilat janë me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e komunave, e të cilët janë paraparë sipas strukturës dhe organizimit komunal. Andaj edhe komunat duhet të koordinojnë veprimet e tyre dhe të dalin me një qëndrim të përbashkët.

Probleme me menaxhimin e mbeturinave komunale? Shkaku mund të jetë modeli juaj i operimit...



Ku qëndron Kosova?

Shërbimet e mbeturinave në Kosovë ofrohet aktualisht nga ndërmarrjet publike në pronësi komunale që janë të organizuara në nivel rajonal (NP). Në vitin 2008 këto NP janë decentralizuar dhe me ndryshimet e Ligjit për Mbeturina në vitin 2012 komunat kanë marrë përsipër kompetencat e plota dhe ekskluzive për ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave. Megjithatë, komunat deri më tani nuk kanë ushtruar detyrën e tyre për të drejtuar sektorin e mbeturinave. Arsyet janë në njërin anë mungesa e fuqisë për të ndikuar tek performanca e Ndërmarrjeve Publike (NP) dhe nga ana tjetër mungesa fuqisë nga NP për të zbatuar mbledhjen e taksës për shërbime. Rezultatet janë që kemi ofruar të shërbimeve joefikas dhe ekonomikisht të paqëndrueshëm si dhe shërbim të dobët për qytetarët.

Si mund të ndryshojmë këtë?

Komunat duhet të udhëheqin dhe të fuqizohen

Një studim i GIZ-së duke krahasuar efikasitetin e modeleve të ndryshme të operimit nga e gjithë bota arrin në përfundimin se nuk ka vetëm një zgjidhje që është e mirë. Megjithatë, ajo gjithashtu arrin në përfundimin se menaxhimi efektiv i mbeturinave lidhet gjithmonë me udhëheqje të fortë komunale. Kështu pra, komunat duhet të fuqizohen për të marrë udhëheqjen. Për Kosovën hapi i parë i reformës është zhvillimi i një njësisë komunale për menaxhim të mbeturinave, ose të paktën një zyrtar përgjegjës brenda komunës. Me mbështetjen e GIZ-së, kryeqyteti i Prishtinës ka arritur këtë hap pas Prizrenit. Komunat e tjera të tilla si Mitrovica, Peja, Ferizaji, Drenasi dhe Gjakova janë duke kaluar nëpër reforma administrative në drejtim të përmbushjes së këtij hapi të rëndësishëm. Këto njësi duhen të kenë një mandat të qartë, një plan të miratuar për menaxhim të mbeturinave dhe mjete monitoruese për të udhëhequr dhe zbatuar punën e tyre. Në fund të fundit, njësitë e mbeturinave kanë nevojë për personel të aftë dhe drejtorë të duhur për të udhëhequr reformën. Komuna pastaj do të vazhdojë me transferimin e përgjegjësisë së mbledhjes së taksës komunale, dhe jo ashtu si aktualisht qëndron me NP. Ky është një hap mjaft kompleks: kërkon një rrezik dhe analizë të hapave, transferimin e regjistrimit të dhënave të klientëve, krijimin e një sistemi të faturimit dhe të pagesave, paraqitjen e nxitësve, duke lënë mënjanë qarkullimin e fondeve kapitale dhe mekanizmat e zbatimit, si dhe një fushatë informuese. Plotësimi i këtyre hapave përfundimisht do të fuqizojnë komunën për të tenderuar shërbimet ose të zgjidhë një tjetër model operimi, si për shembull një partneritet publiko-privat (PPP).

HAPAT E REFORMËS TË MODELIT TË OPERIMIT

Njësi/zyrtari përgjegjës për menaxhim të mbeturinave është themeluar

Sipas ligjit, çdo komunë është e obliguar të caktojë një njësi/ person përgjegjës për menaxhimin e mbeturinave për të mbikëqyruar dhe monitoruar shërbimet e menaxhimit të mbeturinave.

Adaptimi i Rregullorës Komunale

Në rregullore të rishikuar komuna vendos të marrë përsipër mbledhjen tarifës dhe ndryshimin e tarifës aktuale të menaxhimit të mbeturinave në një taksë komunale që do të lejojë kushtëzimin e pagesës me shërbime tjera komunale. Me këtë komuna ka mundësinë në mënyrë të konsiderueshme rritjen e inkasimit dhe të ardhurave komunale.

Transferimi i regjistrimit të klientëve

Në mënyrë që të ketë një listë kredibile të klientëve, komuna ose mund të transferojë regjistrin e të dhënave aktuale nga NP-ja ose të përdor informatat nga regjistri i të dhënave të tatimit në pronë. Në përgatitje për sistemin e ri operativ, të dhënat do të filtrohen nga zyrtarët përkatës të njësisë të mbeturinave.

Programi softuerik është adaptuar

Komunës i nevojitet të instalojë një program kompjuterik për menaxhimin e të dhënave të klientëve si dhe llogaritje të arkëtueshme. Programi do të ndihmojë në monitorim dhe në analizë të rritjes së të hyrave, si dhe në menaxhimin e të dhënave masive.

Përkufizimi i të hyrave

Për të shmangur mundësinë e përdorimit të të hyrave për qëllime tjera, drejtorja duhet të aplikojë për një kod financiar në Drejtorinë e Ekonomisë dhe Financave për të përcaktuar të gjitha të hyrat nga taksat e mbeturinave për shërbimet e menaxhimit të mbeturinave.

Metoda e faturimit, inkasimi dhe kushtëzimi

Komuna mund të vendosë për mënyrën e shpërndarjes së faturimit, duke zgjedhur një kompani private apo Postën e Kosovës. Konsumatorët mund të paguajnë për taksën e menaxhimit të mbeturinave nëpërmjet institucioneve financiare, ose nëpërmjet sportelit vendosur brenda komunës. Mos-pagesa e taksave komunale mund të kushtëzohet me shërbimet e tjera komunale, siç është regjistrimi i veturave.

Sistemi i monitorimit është caktuar

Për të monitoruar ofruesit (publik apo privat) e shërbimeve, komuna do të detyrojë që të gjitha automjetet e grumbullimit të kenë të instaluar një sistem të GPS-it si dhe të vendosin zyre për ankesa të klientëve. Përveç kësaj, inspektorët e mjedisit nga niveli lokal dhe qendror duhet të zbatojnë ligjin në punën e tyre të përditshme.

Informimi i publikut dhe fushata të vetëdijesimit

Paralelisht me të gjitha hapat, një fushatë e fortë informative është e nevojshme për të përgatitur qytetarët për ndryshimet dhe pritshmëritë.

DEMOS-i nis iniciativën për të mbështetur inventarizimin e pronës së paluajtshme komunale




DEMOS-i ka filluar diskutimet me komunat partnere rreth një pakete ndihmëse për të përditësuar inventarizimin e pronës së paluajtshme komunale. Përditësimi i regjistrit të pasurisë komunale është një rekomandim kryesor i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm. Gjatë muajve mars dhe prill të vitit 2016, me

komunat e Rahovecit, Lipjanit, Shtimes dhe Pejës, u dakordua rreth një pakete ndihmëse e cila përbëhet nga një grant i vogël për të mbuluar shpenzimet e anketimit në terren dhe për mbështetje teknike. Nisma është e bazuar në një përfundim të suksesshëm të një përpjekje të ngjashme me


Komunën e Prishtinës gjatë vitit 2015, në të cilën statusi i tokës komunale është verifikuar gjerësisht. Ky proces çoi në hartimin e një metodologjie për verifikim të pronës komunale e cila tani është duke u përdorur si një model për të përsëritur përvojën tek komunat tjera partnere.

DEMOS-i ofron trajnime për zyrtarët komunal të tatimit në pronë

Sipas marrëveshjes me Ministrinë e Financave, DEMOS-i është duke ofruar trajnime në vende të punës për Zyrat Komonale të Tatimit në Pronë te komunave partnere mbi përdorimin efektiv të programeve të tatimit në pronë dhe mbi regjistrat e të dhënave. Trajnimet, të cilat kanë filluar në prill të vitit 2016, kanë për qëllim, ndër të tjera, të rrisin kapacitetin e zyrtarëve të tatimit në pronë për të shfrytëzuar më mirë softuerin për tatimin në pronë. Kapaciteti i zgjeruar është veçanërisht i rëndësishëm duke marrë parasysh ligjin e ri të tatimit në pronë i cili pritet të hyjë në fuqi në muajt e ardhshëm. Trajnimet



në vende të punës kanë për qëllim t'ju mundësoj zyrtarëve të tatimit në pronë të kryejnë analiza të bazuara në softuerë, duke u bazuar në zona dhe kategori të veçanta me qëllim të rritjes së mbledhjes së tatimit në pronë.



Komunave të i'u kthehen pronat e tyre me qëllim të realizimit të interesit publik



Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) organizoi takimin e përbashkët mes përfaqësuesve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) dhe përfaqësuesve të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) me qëllim për të diskutuar lidhur me shqetësimet rreth zbatimit të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe çështjet që kanë të bëjnë me likuidimin e ndërmarrjes ose Kooperates.

Në këtë takim morën pjesë z.Bajram Mulaku – Anëtar i Bordit të AKK-së dhe Kryetar i Komunës së Vushtrrisë, z.Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit, z.Xhafer Gashi - Kryetar i Komunës së Obiliqit, z.Shefik Kurteshi – Drejtor i Departamentit Ligjor në AKP, z.Arben Limani – Drejtor i Sekretariatit të AKP-së, z.Agron Maxhuni – Drejtor i Departamentit Ligjor në MAPL dhe z.Sazan Ibrahim – Drejtor Ekzekutiv i AKK-së.

Në këtë takim u diskutua me theks në Projekt Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit ku Asociacioni i Komunave të Kosovës kërkoi që të inkorporohen vërjetjet dhe kërkesat e komunave. Në takim palët u pajtuan me konkluzionin që të përgatitet një dokument i përbashkët mes AKK-së, MAPL-së dhe AKP-së për t'iu adresuar Ministrisë së Financave si sponsorizuese e këtij Projekt-Ligji.

Kryetarët e Komunave poashtu kërkuan që deri në afërsimin e këtij Projekt – Ligji, të ngrihet procesi i likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore.

Vlen të ceket se ky takim dhe kjo qasje e sapo filluar, rritë mundësitë që bashkëpunimi mes Asociacionit të Komunave të Kosovës si përfaqësuese e Komunave të Kosovës dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit do të vazhdojë dhe të thellohet edhe në të ardhmen në mënyrë që problemet dhe sfidat me të cilat ballafaqohen autoritetet lokale në Republikën e Kosovës të marrin rrugën e zgjidhjes.

Shkurtimisht

- Takimi në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me Komisionin për shënimin e 22 prillit - Dites Botërore të Tokes, me theks tek roli i komunave në shënimin e kësaj date.
- Pjesëmarrja në takimin me Ministrinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për të debatuar mundësinë e ndryshimit të Strategjisë për Zhvillimin e Pyjeve 2010-2020.
- AKK-ja mori pjesë në punëtorinë e organizuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal për të diskutuar "Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave".
- Takimi i Udhëheqësve Komunal të Personelit, organizuar nga AKK-ja me temë diskutimi - Katalogu i vendeve të punës.
- Komunave të Kosovës i'u është shpërndarë për ta shqyrtuar 'Draft Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike dhe Draft Planin e Veprimit për konsultime publike' - për të dhënë komentet dhe rekomandimet e tyre.
- Takimi në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ku me vendim të Ministrit Agani, AKK ka një anëtar në Grupin Punues për monitorimin e Udhëzimit Administrativ për gjobat mandatore.
- AKK-ja mori pjesë në Grupin Punues për hartimin e "Strategjisë për Zhvillimin e Sektorit Privat 2016-2020".
- Për të diskutuar Ligjin për Agjencionin Kosovar të Privatizimit u organizua takim me disa kryetar të komunave, përfaqësues nga Zyra Ligjore e Kryeministrit dhe përfaqësues nga MAPL-ja.
- AKK-ja në bashkëpunim me DEMOS-in për të debatuar lidhur me 'Model Rregulloren për Subvencione' organizoi takimet e Kolegjiumit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Kolegjiumit të Arsimit dhe Kulturës, Kolegjiumit të Zhvillimit Ekonomik, Kolegjiumit të Buxhetit dhe Financave dhe Kolegjiumit të Zyrtarëve.

ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

BULETINI

Viti XIII. Nr. 77 • Mars - Prill 2016

Tel: 038 245-734; Fax: 038 245-733

E-mail: info@komunat-ks.net

Web: www.komunat-ks.net

AKK-ja ka statusin e vëzhguesit në Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale në Evropë të Këshillit të Evropës. Është Anëtar i Përhershëm i NALAS-it (Rrjeta e Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës JugLindore), anëtar i Rrjetit LOGIN, anëtar i Rrjetit LOGON. Anëtar në pozitën Asociacion i Ftuar (i ngjashëm me pozitën e anëtarit vëzhgues) në Komitetin Evropian të Komunave dhe Regjioneve (CEMR) si dhe anëtar në ALDA (Asociacioni i Agjencive për Demokraci Lokale).

